



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

**RAPORT PËR CILËSINË E AJRIT NË PRISHTINË GJATË DITËVE TË
FUNDIT 16-19.10.2017 TË DHËNAT JANË MARR NË DY STACIONET NË RILINDJE DHE IHMK**

Cilësia e ajrit monitorohet përmes sistemit të matjeve automatike kontinuale. Parametrat që monitorohen janë: Dioksidi i sulfurit (SO₂), Ozoni (O₃), Dioksidi i azotit NO₂ dhe grimcat e suspenduara në ajër PM10 dhe PM2.5.

Rezultatet e mbledhura nga matjet automatike të parametrave ndotës të ajrit përpunohen, validohen dhe bëhet analiza e tyre për të dhënë një vlerësim të gjendjes së cilësisë së ajrit në zonën e monitorimit.

Vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit bëhet duke bërë krahasimin e vlerave të rezultateve të fituara me vlerat standard të lejuara sipas ligjeve dhe rregulloreve vendore në fuqi dhe sipas direktivës 2008/50 EC për Ajër të Pastër në Evropë.

Bazuar në matjet e realizuara nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, nga analiza e rezultateve të fituara nga monitorimi automatik i cilësisë së ajrit është vërejtë së gjatë ditëve të fundit janë paraqite tejkalime të vlerave kufitare ditore me PM10, në të dy lokacionet në Rilindje dhe në IHMK. Vlera kufitare ditore e lejuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut është 50ug/m³, ndërsa gjatë këtyre ditëve ka pasur tejkalime në të dy stacionet në Prishtinë.

Në Stacionin e Rilindjes janë shënuar këto vlera si me poshtë:

Me datë 18.10.2017 është shënuar **62.9 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Me datë 17.10.2017 është shënuar **58.7 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Me datë 16.10.2017 është shënuar **53.4 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Në Stacionin e IHMK janë shënuar këto vlera si me poshtë:

Me datë 18.10.2017 është shënuar **70.6 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Me datë 17.10.2017 është shënuar **68.8 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Me datë 16.10.2017 është shënuar **53.4 $\mu\text{g}/\text{m}^3$**

Vlera me e larte **70.6 $\mu\text{g}/\text{m}^3$** , është regjistruar në stacionin e IHMK-se e cila është mbi normat e lejuara. Për me shumë shih grafikonet në vazhdim.




Fig. Nr.1 Paraqet përqëndrimin e PM10 dhe PM2.5 në Prishtinë (Stacioni Rilindje)

Ndërsa përqëndrime të larta janë paraqitur edhe me ndotësin PM2.5 gjate këtyre ditëve i cili ka arrite vlerën maksimale e mesatares ditore **40 $\mu\text{g}/\text{m}^3$** . Me date 17.10.2017. (Stacioni Rilindje)




Fig. Nr.2 Paraqet përqëndrimin e PM10 dhe PM2.5 në Prishtinë (Stacioni IHMK)

Ndërsa përqëndrime të larta janë paraqitur edhe me ndotësin PM2.5 gjate këtyre ditëve i cili ka arrite vlerën maksimale e mesatares ditore **33.5µg/m³**. Me date 17.10.2017. (IHMK)

Shënim: # Vlerësimi i përqëndrimit të grimcave PM 2.5 në përputhshmëri me standardet e kualitetit të ajrit bëhet duke u bazuar ne vlerën vjetore.